



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 247/5 prot.

Tiranë, më 14.6.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 6.6.2024, është njoftuar vendimi nr. 760, datë 26.4.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Bera, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuar për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*referuar në vijim si ILDKPKI*), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*referuar në vijim si DSIK*), nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*referuar në vijim si KLGJ*).

4. Nga raportet rezultojnë se:

4.1 ILDKPKI², në “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ardiana Bera”, ka konstatuar:

- (i) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit Raportin³ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, dhe ka referuar: [...] *Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Ardiana *** Bera [...].*

4.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.

5. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

5.1 Për vlerësimin e pasurisë: [...] *Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezultojnë të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përprjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2005 në vlerën -115.068 lekë, për vitin 2006 në vlerën -112.709 lekë dhe për vitin 2007 në vlerën -337.489 lekë, për gjithë periudhën e deklaramit nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

² Me shkresën nr. ***/** prot., datë **.3.2018.

³ Raporti me nr. ***/** prot., datë **.11.2017 i DSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë **.10.2023 të KDZH-së.

⁴ Raporti i KLGJ-së nr. ***/** prot., datë **.12.2020.

e kriterit të pasurisë, mospërputhjet e reflektuara në dokumentacionin ligjor të përfitimit të pasurisë apartament si pasaktësi në veprimin e ligjshëm që passjell disponimin e kësaj pasurie nga subjekti dhe pamundësia financiare për krijimin e gjendjes cash të deklaruar në fund të vitit 2003, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Komisioni, pas hetimit të kryer, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...].⁵

5.2 Për kontrollin e figurës: [...] Komisioni ka arritur në konkluzionin për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera [...].⁶

5.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale: [...]trupi gjykues arrin në konkluzionin se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...].⁷

6. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli trupi gjykues i Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit): [...] Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë [...].

II. Shkaqet e ankimit

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁵ Referohuni vendimit të Komisionit, faqe 26, prg. 19, 19.1, 19.2 dhe 19.3.

⁶ Referohuni vendimit të Komisionit, faqe 27, prg. 20.4.

⁷ Referohuni vendimit të Komisionit, faqe 29, prg. 22.15.

11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 760/2024, çmon se ai është i cenueshëm, përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 760/2024, të Komisionit, në tërësinë e tij.

II.A Analiza e shkaqeve të ankimit

13. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore dhe asaj Vetting, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 24.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi janë:

15. Pasuria e paluajtshme "Apartament me sipërfaqe totale 136,7 m²", ndodhur në rrugën "** **", Tiranë**

15.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Banesë me sipërfaqe totale 136.7 m² e ndodhur në adresën rruga "**** **", pall. "**** sh.p.k.". Pasuri e krijuar në vitet 2002 – 2011, sipas kontratës së shitblerjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë **.9.2011. Burimi i krijimit: (i) Shitja e banesës në qytetin e Krujës me kontratën e shitjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë **.9.1999; (ii) kursimet familjare në vite të familjes së bashkëshortit; të ardhurat dhe shpërblimet nga puna e subjektit deklarues dhe bashkëshortit; kursimet familjare dhe (iii) ndihma e familjarëve të subjektit të deklaruar në vite (shiko të dhënat konfidenciale). Vlera: 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50% [...].*

15.1.1 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën "Të dhëna konfidenciale", subjekti ka deklaruar: [...] *siç kam deklaruar në vitin 2004, (për periudhën kohore **.1.2003 - **.12.2003), unë, subjekti deklarues kisha marrë hua pa kontratë, pa afat dhe pa interes, shumën prej 2.000.000 lekë tek vëllezërit e mi, ****. ****. (në atë kohë emigrant ekonomik që nga viti 1992, në shtetin anglez ku vazhdon dhe aktualisht), dhe ****. ****. (në atë kohë emigrant ekonomik në shtetin anglez), për nevojat e blerjes së banesës [...].*

15.2 Në Deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI, në datën **.3.2004, subjekti ka deklaruar: [...] (i) *Shtëpi banimi, rruga "**** **", tek firma **** sh.p.k., Tiranë. Blerë me kontratë sipërmarrjeje datë **.3.2002, nga firma **** sh.p.k. Burimi i krijimit: Nga shitja e banesës 3+1 në qytetin e Krujës në shumën 2.000.000 lekë, nga të ardhurat nga pagat dhe me huamarrje. Nuk është paguar e gjithë shuma. Vlera: 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

15.2.1 Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të po kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: [...] (i) Detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 2 milionë lekë për blerje banese sipas kontratës së sipërmarrjes datë 16.3.2002; (ii) Detyrim ndaj shtetasve *** dhe *** *** (vëllezërit e subjektit) në shumën 2.000.000 lekë, për blerjen e banesës me kontratë sipërmarrje, datë *.3.2002 [...].

15.3 Në Deklaratën e parë të pasurisë, në rubrikën “Formulari A-5, Likuiditete”, subjekti ka deklaruar gjendje cash në banesë në shumën 5.000.000 lekë. Burimi i krijimit është me shkrim dore i palexueshëm.

15.4 Në DV-2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] Pakësuar gjendja cash gjatë vitit 2004, në banesë 3.000.000 lekë, mbetur 2.000.000 lekë [...]. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit me kontratë sipërmarrje, datë *.3.2002, në vitin 2003 ka paguar 2.000.000 lekë, në vitin 2004 ka paguar 3.000.000 lekë dhe ka mbetur pa paguar shuma 1.000.000 lekë.

15.5 Në DV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] Pakësimin e detyrimit në shumën 10.000 USD për kontratën e sipërmarrjes për blerjen e apartamentit të deklaruar në deklaratën e pasurisë datë *.3.2003. Pagar me kursime nga paga dhe nga kursimet e mbartura. Minus 600.000 lekë [...].

15.6 Në DV-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për pasurinë “Apartament me sipërfaqe 136,7 m²” është hartuar kontrata e shitblerjes datë *.9.2011 dhe është regjistruar pasuria.

15.7 Lidhur me këtë pasuri, në dosje të Komisionit, ndër të tjera janë administruar: (1) Kontratë Sipërmarrje e lidhur në datën *.3.2002, me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë *.3.2002, ndërmjet sipërmarrësit, shoqërisë “****” sh.p.k., me palë porositëse, znj. Ardiana Bera. Me anë të kësaj kontrate palët kanë dakordësuar porositjen e një apartamenti me sip. 136,7 m², kundrejt vlerës 54.600 USD. Në kontratë citohet se mënyra e pagesës do të jetë: (i) cash 30.000 USD me lidhjen e kontratës dhe (ii) pjesa tjetër kur të mbarojnë punimet; (2) Kontratë shitblerje nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë *.9.2011, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse znj. Ardiana Bera, me objekt blerje të pasurisë me nr. */***+*.*, ndodhur në zonën kadastrale nr.***, Tiranë, me sipërfaqe 136.7 m², me çmim shitblerje 6.000.000 lekë, në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë *.3.2002⁸; (3) Shkresë datë *.10.2023 nga shoqëria “****” sh.p.k., ku ka konfirmuar se, pavarësisht kontratës së sipërmarrjes, me vullnetin e të dyja palëve, kështu e pagesave janë bërë në arkën e shoqërisë me mandatet: (i) nr. **, datë *.3.2002, në shumën 14.300 USD; (ii) nr. **, datë *.1.2004, në shumën 2.000.000 lekë; (iii) nr. ***, datë *.12.2004, në shumën 1.000.000 lekë; (iv) nr. ***, datë *.11.2005, në shumën 10.000 USD. Gjithashtu, shoqëria ka informuar se, meqenëse kursi i dollarit gjatë këtyre viteve ka pësuar rënie, duke vlerësuar dhe punimet e kryera nga vetë klientja, detyrimi përfundimtar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., i pasqyruar dhe në kontratën e shitjes datë *.9.2011, është 6.000.000 lekë, i cili është shlyer totalisht nga klientja Ardiana Bera.

⁸ Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se me kontratën e sipërmarrjes të datës *.8.2001, bashkëshorti i saj, z. ***, ***, kishte porositur një apartament tjetër tek e njëjta shoqëri ndërtuese, “****” sh.p.k., e cila ishte anuluar me dëshirën dhe vullnetin e palëve në datën *.10.2002, në zyrat e shoqërisë, duke iu kthyer personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, dhe vlera e paguar prej tij, prej 20.000 USD, sipas mandatpagesës së datës *.10.2002.

15.8 Komisioni, lidhur me burimet e krijimit të deklaruara për pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 136,7 m²*” ka konstatuar se:

15.8.1 *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit 3+1 në qytetin e Krujës*, nga aktet në dosje rezulton se ky apartament është shitur me kontratë shitje nr.*/*/*, datë */.9.1999, kundrejt shumës 1.500.000 lekë. Komisioni ka vlerësuar që në analizën financiare paraprake të merret në konsideratë si burim krijimi për pasurinë objekt hetimi vetëm shuma 500.000 lekë, e cila i përket pjesës takuese të bashkëshortit të subjektit sipas kontratës së shitjes së datës */.9.1999.

15.8.2 *Lidhur me huamarrjen e deklaruar në shumën 2.000.000 lekë nga vëllezërit e subjektit*, Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave të vëllezërve të saj (persona të tjerë të lidhur) për dhënien e shumës 2.000.000 lekë, në mars të vitit 2002. Si rezultat, ka vlerësuar të mos merret në konsideratë si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi shuma prej 2.000.000 lekësh.

15.8.3 *Lidhur me kursimet familjare dhe të ardhurat nga pagat*, Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur që përmbushin kriteret e nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës, ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat e kësteve për pasurinë e paluajtshme “*Apartament me sipërfaqe 136,7m²*”. Komisioni, për shkak të mospërputhjeve ndërmjet kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së shitblerjes, ka kryer analizën financiare në dy variante referuar pagesave sipas kontratës së sipërmarrjes dhe sipas kontratës së shitblerjes dhe mandateve të pagesave.

15.9 Lidhur me pagesat e kryera për pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 136,7 m²*”, ka rezultuar se:

15.9.1 *Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2002*, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për këtë pagesë sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatarkëtimit, në shumën 14.300 USD, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, duke rezultuar me balancë negative në vlerën -544.701 lekë⁹.

15.9.2 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit, referuar analizave financiare të kryera sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes, rezulton me pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën.

15.9.3 *Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2004*, në shumën totale 3.000.000 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi në DV-2004 pakësim të gjendjes *cash* në shumën 3.000.000 lekë. Komisioni, fillimisht, ka analizuar mundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti në *Deklaratën e parë të pasurisë*, për sa burimi i deklaruar për pagesën 3.000.000 lekë, në vitin 2004, është gjendja *cash* në fund të vitit 2003. Nga analiza financiare paraprake ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kursyer shumën 5.000.000 lekë të

⁹ Referuar analizës së kryer nga Komisioni në variantin referuar pagesave sipas kontratës së sipërmarrjes, ka rezultuar pamundësi financiare në vlerën 2.765.780 lekë.

deklaruar si kursim *cash* në *Deklaratën e parë të pasurisë* dhe që në vijim ka shërbyer për pagesat e kryera në vitin 2004, për një diferencë negative në vlerën -2.643.472 lekë¹⁰.

15.9.3.1 Komisioni ka vlerësuar se likuiditeti që duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të vitit 2004 është vetëm vlera e gjendjes *cash* që mbulohet me burime të ligjshme¹¹.

15.9.3.2 Në vijim, Komisioni ka kryer analizën financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të pagimit të kësteve të pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 136.7 m²*”, sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatarkëtimeve për vitin 2004, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, për një diferencë negative në vlerën -176.180 lekë¹². Si rezultat, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, pasi duket se subjekti i rivlerësimit, referuar analizave financiare të kryera sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes, rezulton me pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2004.

15.9.4 *Lidhur me pagesën e shumës 10.000 USD në vitin 2005*, rezulton se në DV-2005, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë pagesë, kursimet nga paga dhe kursimet e mbartura. Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pagesës së kështit të apartamentit në vitin 2005, sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatit përkatës. Nga analiza ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2005, për një balancë negative, në vlerën -839.068 lekë, deri në momentin e kryerjes së pagesës (datë **.11.2005) dhe në vlerën -715.068 lekë, për të gjithë vitin 2005¹³. Në vijim, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit, referuar analizës financiare, ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë.

15.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka pretenduar se analiza financiare duhet të përfshijë vlerën totale të përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Krujës, gjendjen *cash* të deklaruar në vitin 2003 dhe huan e marrë nga vëllezërit e saj. Ndërsa lidhur me analizën financiare për vitin 2005, subjekti ka pretenduar se në këtë analizë nuk është evidentuar shuma 600.000 lekë,¹⁴ e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k.

15.11 Komisioni, lidhur me pagesat e kryera për pasurinë “*Apartamenti me sipërfaqe 136,7 m²*”, ka arritur në përfundimet se:

[...] Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2002 ... Referuar dokumentacionit ligjor, kontratës të shitjes së apartamentit në qytetin e Krujës, ka rezultuar se të ardhurat e përfituara nga shitja kanë qenë në vlerën 1.500.000 lekë, vlerë kjo për të cilën provohet pagimi i detyrimeve tatimore dhe regjistrimi i pasurisë në emër të blerësit, ndaj kjo vlerë u vlerësua të pasqyrohet në analizën

¹⁰ Referuar analizës së kryer nga Komisioni sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes, hartuar mes palëve, ka rezultuar pamundësi financiare në vlerën -4.864.551 lekë.

¹¹ Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 14 e vendimit.

¹² Referuar analizës së kryer nga Komisioni, sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes hartuar mes palëve, ka rezultuar pamundësi financiare në vlerën -2.397.259 lekë.

¹³ Referohuni analizës financiare, në f. 16-17 të Rezultateve të hetimit administrativ.

¹⁴ Referohuni shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime përfundimtare, datë.19.4.2024.

financiare të subjektit e personit të lidhur dhe të konsiderohet si burim krijimi për apartamentin objekt i këtij hetimi ... Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të pagimit të kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2002, sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatit përkatës, duke provuar mundësinë financiare të saj dhe personit të lidhur, që me të ardhura të ligjshme të mundësonte pagimin e kësaj në datën **.3.2002, në shumën 14.300 USD, për këtë pasuri të paluajtshme.

Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2004 ... Edhe pas kalimit të rezultateve të hetimit referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues dhe të dokumentojë pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e vëllezërve të saj për dhënien e shumës prej 2.000.000 lekësh, në mars të vitit 2002. Informacioni i plotë i shoqëruar me dokumentacion ligjor provues në formën e kërkuar nga ligji, për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e huadhënësve fillon pas datës së deklaruar si dhënie e huas ... Pas marrjes në konsideratë në analizën financiare përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, vetëm të vlerës 1.500.000 lekë, sipas arsyetimit të mësipërm, ... trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë likuiditetin e deklaruar për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, duke rezultuar me balancë negative në vlerën -1.669.152 lekë, për krijimin e gjendjes cash të deklaruar nga subjekti, në fund të vitit 2003. Trupi gjykues vlerëson se likuiditeti që duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të vitit 2004, është vetëm vlera e gjendjes cash e provuar lidhur me ligjshmërinë, konkluzion i mbështetur në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit... Për rrjedhojë, vetëm vlera 3.330.848 lekë, e provuar për sa i përket ligjshmërisë së saj do të merret në konsideratë në analizën financiare përfundimtare... Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për krijim të pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2004.

Lidhur me pagesën për shoqërinë ndërtuese në vitin 2005 ... trupi gjykues vlerëson se vlera 600.000 lekë, e shpenzuar prej vetë subjektit e bashkëshortit, në datën **.5.2003, dhe e përfshirë në analizën financiare të subjektit deri në vitin 2003, sipas tabelës nr. 5 në këtë vendim, duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur, si vlerë e kthyer nga shoqëria ndërtuese në vitin 2005 ... trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerje pasurie, shtesë në likuiditet të deklaruar dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2005, duke rezultuar me një balancë negative për vitin në vlerën -115.068 lekë [...].

15.12 Komisioneri Publik, në referencë të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ lidhur me burimet e krijimit të pasurisë “Apartament me sipërfaqe 136,7 m²”, vëren se:

15.12.1 Në D-Vetting dhe në Deklaratën e parë të pasurisë, vetë subjekti i rivlerësimit deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “Apartament banimi me sipërfaqe 136,7 m²”, huan në shumën 2.000.000 lekë, marrë nga vëllezërit e saj, për të cilën, bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk provohet ligjshmëria e burimit të krijimit të kësaj shume nga huadhënësit.

15.12.2 Gjithashtu, nuk u provua mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të mbuluar plotësisht me burime të ligjshme kursimet cash të deklaruara në Deklaratën e parë të pasurisë, në shumën 5.000.000 lekë, të cilat, në deklaratat periodike vjetore në vijim

deklarohen si burim krijimi për këstet e paguara për blerjen e pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 136.7 m²*”. Sikurse është konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara në *Deklaratën e parë të pasurisë*, për një diferencë negative në vlerën -1.669.152 lekë.

15.12.3 Sa më sipër, në kushtet kur: (i) nuk u provua mbulimi me burime të ligjshme i huas në shumën 2.000.000 lekë nga personat e tjerë të lidhur; dhe (ii) nuk u provua krijimi me burime të ligjshme i kursimeve *cash* të deklaruara si burim krijimi për këstet e paguara për blerjen e pasurisë “*Apartament me sipërfaqe totale 136,7 m²*”, në vitin 2004, vlerësojmë se këto rrethana që lidhen me burimet e deklaruara, afektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme këstet e blerjes së pasurisë “*Apartamentit me sipërfaqe 136.7 m²*”.

15.12.4 Lidhur me pagesën e këstit të fundit, në shumën 10.000 USD në vitin 2005, vlerësojmë se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitin 2005, në vlerën - 715.068 lekë.

15.12.5 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për përfshirjen e shumës 600.000 lekë, në analizën financiare të vitit 2005, bie ndesh me aktet e administruara në dosje dhe nuk duhet konsideruar në analizën financiare të vitit 2005, pasi rezulton se: (i) në D-Vetting, në deklaratat periodike vjetore dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vlerë për blerjen e apartamentit shumën 6.000.000 lekë; (ii) Në kontratën e shitblerjes, datë **.9.2011, palët kanë rënë dakord që çmimi i shitblerjes së pasurisë është 6.000.000 lekë; (iii) Mandatpagesat e depozituara për këtë pasuri janë në total në vlerën 6.000.000 lekë;¹⁵ (iv) Në shkresën e shoqërisë “***” sh.p.k. konfirmohet dhe njëherë se, pavarësisht kontratës së sipërmarrjes që ka vlerën 54.600 USD, janë kryer dy pagesa në USD dhe dy pagesa në lekë, që në total janë në vlerën 6.000.000 lekë. Gjithashtu, shoqëria ka informuar se, meqenëse kursi i dollarit gjatë këtyre viteve ka pësuar rënie, duke vlerësuar dhe punimet e kryera nga vetë klientja, detyrimi përfundimtar ndaj shoqërisë “Lura” sh.p.k., pasqyruar dhe në kontratën e shitjes, datë **.9.2011, është 6.000.000 lekë, i cili është shlyer totalisht nga klientja Ardiana Bera; (v) Nuk është administruar asnjë dokument i kohës, që të provojë kthimin e kësaj shume të pretenduar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

15.13 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat e kryera për blerjen e pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 136,7 m²*”, si dhe kursimet *cash* të deklaruara si burim krijimi për këto pagesa, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

16. Pasuria automjet tip “Mercedes Benz”, me targë *, blerë në datën **.2.2007**

16.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Autoveturë e markës Mercedes Benz, e blerë me kontratën nr. *** rep., nr. ***/* kol., datë **.2.2007. Burimi i krijimit: Nga kursimet familjare, nga pagat, nga të ardhurat e përfituara nga shitja e autoveturës Volkswagen Golf, e cila është blerë në shumën 300.000 lekë, me kontratën e datës **.5.2005, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., dhe është shitur në shumën 400.000 lekë, me kontratën nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.11.2007. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese 50% [...].*

¹⁵ Nga aktet në dosje rezulton se dy nga mandatet janë në vlerën 24.300 USD (ekuivalenti me kursin e kohës kur janë kryer pagesat është rreth 3.000.000 lekë) dhe dy mandate të tjera janë në shumën 3.000.000 lekë.

16.2 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Me kontratën noteriale nr. *** rep. dhe nr. ***/* kol., datë **.2.2007, është blerë autovetura tip "Mercedes Benz", me targë ***. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese 50% [...].* Nuk deklarohet burimi i krijimit.

16.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.1.2021, ka konfirmuar se në emër të subjektit dhe personit të lidhur figuron i regjistruar automjeti me targë ***. Nga aktet bashkëlidhur kësaj shkrese rezulton se ky automjet është blerë nga subjekti dhe personi i lidhur me kontratë shitblerje nr. *** rep. dhe nr. ***/* kol., datë **.2.2007, nga shtetasi *** kundrejt çmimit 500.000 lekë.

16.4 Komisioni ka konstatuar se shtetasi *** rezulton ta ketë blerë këtë automjet në datën **.2.2007 (rreth 13 ditë më parë), në shumën 3.100 euro, si dhe ka shlyer detyrimet doganore në shumën 267.272 lekë në datën **.2.2007. Sa më sipër, për këtë automjet, nga shtetasi ***. rezulton të jenë shpenzuar rreth 653.470 lekë (3.100 euro*124.58 lekë/euro + 267.272 lekë), pa shpenzime të transportit. Si rezultat, Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare shumën 653.470 lekë, si shumë e blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur.

16.5 Në vijim, Komisioni ka analizuar dy burimet e krijimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në D-Vetting, si vijon: (1) lidhur me burimin e deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit tip "Volkswagen Golf", ka vlerësuar se shuma prej 400.000 lekësh, referuar kontratës së shitblerjes është marrë në datën **.11.2007 dhe nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip "Mercedes-Benz", në datën **.2.2007; (2) lidhur me burimin e deklaruar kursime familjare, nga aktet në dosje ka rezultuar se në datën **.2.2007 (dy ditë para blerjes së automjetit), subjekti ka tërhequr *cash* nga llogaria e saj në *** Bank shumën 8.000 euro. Shuma 8.000 euro rezulton të jetë tërhequr nga depozita në shumën 9.000 euro, e depozituar *cash* në datën **.12.2006.

16.6 Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DV-2006 llogarinë bankare në euro në *** Bank, në shumën 9.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj, ndërsa lidhur me likuiditet *cash*, të disponuara në **.12.2006, ka deklaruar, ndër të tjera, dhe shumën 9.000 euro si kursim *cash*, për të cilën gjatë hetimit administrativ ka pretenduar që kjo shumë nuk ka qenë *cash*, por bëhet fjalë pikërisht për depozitën në *** Bank.

16.7 Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën **.1.2006 - **.12.2006 mbi mundësinë e krijimit të kursimeve në shumën 9.000 euro, në datën **.12.2006. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ku duket se nuk është përfshirë si shpenzim kthimi i huas kundrejt vëllezërve të subjektit në shumën 1.000.000 lekë, sikurse është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DV-2006, ka rezultuar një pamjaftueshmëri prej -187.083 lekësh¹⁶.

16.8 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën.

16.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se ka disponuar *cash* në fillim të vitit 2006 dhe se analiza financiare korrekte do të ishte ajo e ndërtuar në fund të periudhës së deklarimit. Në vijim, subjekti ka paraqitur një analizë financiare që

¹⁶ Nga aktet në dosje rezulton se Komisioni ka kryer dhe analizën financiare për gjithë vitin 2006, ku rezultoi pamundësia financiare në vlerën -112.709 lekë, si dhe analizën financiare për periudhën **.1.2007 – **.2.2007, nga e cila duket se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për periudhën **.1.2007 – **.2.2007, për blerjen e automjetit tip "Mercedes Benz" dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me një balancë negative prej -456.475 lekësh.

përfshin gjendjen *cash* në fillim dhe në fund të vitit 2006 sipas deklarimeve periodike,¹⁷ si dhe kthimin e huas kundrejt vëllezërve të saj në shumën 1.000.000 lekë, deklaruar në DV-2006. Në analizën e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit rezulton një mungesë e burimeve të ligjshme për realizimin e kursimeve, shpenzimeve dhe shlyerjen e huas në vitin 2006, në vlerën -266.117 lekë.

16.10 Për sa më sipër, Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar se: [...] *qëndron pretendimi i subjektit mbi marrjen në konsideratë të llogarisë bankare të tërhequr në vitin 2007, e cila rezultoi e provuar për sa i përket ligjshmërisë në vlerën 7.490 euro. Marrja në konsideratë e gjendjes në llogarinë bankare të tërhequr në vitin 2007 ... konsiderohet nga trupi gjykues se provon burimin e ligjshëm për pagesën e automjetit dy ditë pas tërheqjes së depozitës [...]*¹⁸.

16.11 Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa *** dhe depozitën në shumën 9.000 euro, që deklarohet se ka shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, vëren se:

16.11.1 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa ***, pasi në DV-2007 nuk deklaroi burim krijimi, ndërsa në D-Vetting deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, që rezultoi të jetë shitur disa muaj më vonë.

16.11.2 Sa i takon mbulimit me burime të ligjshme të depozitës në shumën 9.000 euro, që deklarohet si burim krijimi për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, në të gjitha variantet e analizës financiare të administruara në dosje, përfshirë dhe atë të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ka rezultuar mungesë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Vërejmë që, dhe në analizën financiare të depozituar nga subjekti, ku përfshihen likuiditetet *cash* në fillim dhe në fund të vitit 2006, si dhe huaja e deklaruar e shlyer në shumën 1.000.000 lekë, ka rezultuar një diferencë negative në vlerën -266.117 lekë. Nëse në këtë analizë do të përfshihej edhe shuma 9.000 euro, që subjekti e ka deklaruar si kursim *cash* në DV-2006, por gjatë hetimit ka deklaruar se këtë shumë nuk e ka disponuar *cash*, por në llogari bankare, atëherë diferenca negative do të ishte ndjeshëm më e lartë. Çmojmë të theksojmë këtu dhe faktin që kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratën e parë të pasurisë dhe që mbarten në vitet pasuese kanë rezultuar se nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme, sikurse trajtuar më sipër në këtë ankim.

16.12 Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e mësipërme lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa ***, blerë në datën **.2.2007, duhen marrë në konsideratë nga Kolegji në një vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

17. Llogaria “**” në lekë, në emër të vajzës së subjektit, në *** *** Bank**

17.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Llogari “Futura” në lekë+plus interesa, në emër të vajzës *** ***, pranë bankës *** *** Albania, e hapur në **.6.2007. Burimi i krijimit: Dhurata nga familjarët e subjektit dhe bashkëshortit të subjektit, miqtë me*

¹⁷ Në DV-2005, subjekti ka deklaruar: Gjendja *cash* e mbartur nga vitet, euro 3.000 dhe lekë 2.000.000, ndërsa në DV-2006, ka deklaruar gjendja *cash* e mbartur nga vitet, euro 3.000, euro 9.000 dhe lekë 1.200.000.

¹⁸ Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 19 e vendimit, prg. 13.22 dhe 13.23.

*rastin e lindjes së fëmijës ** *** dhe në rastet e ditëlindjes së saj, nga kursimet familjare, nga pagat plus shpërblime nga puna, orë pune jashtë orarit. Vlera 2,132,809.02 lekë. Pjesë takuese 50% [...].*

17.2 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *kisha marrë hua shumën 2.000.000 lekë nga vëllezërit e mi ... Nga kjo hua e marrë, shuma 1.000.000 lekë, iu bë dhuratë vajzës time [...].*

17.3 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Detyrimi ndaj vëllezërve, i deklaruar në vitin 2003, në shumën 2.000.000 lekë, dhënë nga ana e tyre pa afat dhe interes, iu shlye vetëm për shumën 1.000.000 lekë. Shuma tjetër, prej 1.000.000 lekësh, iu bë dhuratë nga ana e tyre dhe prindërve me rastin e lindjes së vajzës, ***. ***, në janar 2006, familjes time [...].*

17.4 Në DV-2007, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Kontratë për llogarinë e kursimeve “Fonde për të ardhmen e fëmijës”, shuma 1.000.000 lekë, në Bankën *** **** (dhuratë e deklaruar në vitin 2006) [...].*

17.5 Referuar informacionit të përcjellë nga *** ** Bank me shkresën nr. **/**/* prot., rezulton se kjo llogari bankare është hapur në datën **.6.2007, me një depozitim *cash* nga subjekti i rivlerësimit të shumës 1.000.000 lekë. Në vijim, kjo llogari është shtuar me depozitime *cash* dhe interesa bankare dhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 rezulton në vlerën 2,132,809.02 lekë.

17.6 Komisioni, referuar analizës së kryer, lidhur me huan e marrë nga vëllezërit e subjektit, ka arsyetuar se ky burim mbeti i paprovuar për sa i përket burimit të ligjshëm, e për pasojë, edhe burimi i deklaruar, shuma 1.000.000 lekë, nga kjo hua, e cila shërbeu për krijimin e depozitës në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit, mbeti e paprovuar për sa i përket burimit të ligjshëm. Në vijim, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën **.2.2007 – **.6.2007, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të dhe personit të lidhur për krijimin e depozitës në emër të vajzës, në shumën 1.000.000 lekë, nga ku ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën -704.358 lekë.

17.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës në emrin e vajzës, si dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2007 dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

17.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, lidhur me këtë pamjaftueshmëri financiare, ndër të tjera, ka pretenduar se analiza financiare e bërë për depozitën e vajzës shkëput të ardhurat e siguruar gjatë muajit janar dhe gjendjen *cash* në banesë në fillim të këtij viti, si dhe mundësinë e plotësimit të kësaj gjendjeje gjatë të njëjtit vit.

17.9 Komisioni, në përfundim, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *pretendimet e subjektit mbi saktësimin e ndryshimit të likuiditeteve në bankë dhe mbi përdorim e gjendjes cash, të disponueshme për t’u përdorur e plotësuar nga subjekti brenda të njëjtit vit deklarimi, qëndrojnë dhe duhet të merren në konsideratë, duke arritur të provojnë burimin e të ardhurave*

*të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e depozitës në emrin e vajzës, në datën **6.2007¹⁹ [...].*

17.10 Në vijim, nisur nga fakti që në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, me kontratën e datës **2.2007, dhe krijimin e llogarisë “****” në lekë, në emër të vajzës, hapur më 18.6.2007, Komisioni ka kryer dhe një analizë përfundimtare financiare gjithëpërfshirëse për vitin 2007, nga ku ka rezultuar një balancë negative përfundimtare për vitin 2007, në vlerën -377.480 lekë.

17.11 Komisioni, në vlerësimin përfundimtar lidhur me kriterin e pasurisë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] mungesa e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2005 në vlerën -115.068 lekë, për vitin 2006 në vlerën -112.709 lekë dhe për vitin 2007 në vlerën -337.489 lekë, për gjithë periudhën e deklaramit nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera²⁰ [...].*

17.12 Komisioneri Publik, nga analizimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, vëren se, edhe duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, se si burim krijimi kanë shërbyer kursimet *cash* të disponuara në fillim të vitit, të cilat më pas janë zëvendësuar përsëri me të ardhurat e vitit respektiv, nga analiza vjetore e Komisionit, ka rezultuar se pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2007 nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme. Sa i takon pamjaftueshmërisë së konstatuar për vitin 2007, Komisioneri Publik vëren se, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 nuk janë llogaritur sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit²¹, llogaritja e të cilave sipas këtij standardi e çon pamjaftueshmërinë e vitit 2007 në vlerën -716.209 lekë²².

17.13 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në vitin 2007, përfshirë këtu dhe krijimin e llogarisë “****” në lekë, në emër të vajzës. Konstatohet po ashtu se, për krijimin e llogarisë në emër të vajzës, në vitin 2007, janë deklaruar si burim shumëat e dhëna nga vëllezërit në formë huaje/dhurimi, për të cilat nuk është provuar ligjshmëria e burimit të krijimit.

18. Në përfundim, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] mungesa e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2005 në vlerën -115.068 lekë, për vitin 2006 në vlerën -112.709 lekë dhe për vitin 2007 në vlerën -337.489 lekë, për të gjithë periudhën e deklaramit, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, mospërputhjet e reflektuara në dokumentacionin ligjor të përfitimit të pasurisë apartament, si pasaktësi në veprimin e ligjshëm që passjell disponimin e kësaj pasurie nga subjekti dhe pamundësia financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2003, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i*

¹⁹ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen nr. 21 të vendimit.

²⁰ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen nr. 26 të vendimit.

²¹ Referuar jurisprudencës së Kolegjit dhe informacionit të përcjellë institucioneve të rivlerësimit nga ILDKPKI/INSTAT, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 llogariten në vlerën 235.968 lekë për person.

²² Automjeti i shitur në shumën 400.000 lekë është blerë 300.000 lekë.

rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë [...].

19. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky arsyetim i Komisionit nuk qëndron, pasi, përveç sa trajtuar më sipër në këtë ankim, dhe vetë rezultati financiar negativ i konstatuar nga Komisioni për vitet 2003, 2005, 2006 dhe 2007, në vlerën rreth - 2.200.000 lekë, tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.

20. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

II.B Çështje të tjera

21. Rezulton se gjatë procedurave të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioni çmoi dhe bëri pjesë të hetimit administrativ, duke ia përcjellë gjetjet përkatëse në aktin “Rezultate të hetimit” edhe vendimin nr.***, datë **.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupës gjykuese.

22. Ndërkohë konstatohet se, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura me shkrim nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka parashtruar qëndrimin se, duke qenë se jemi në kushtet e një çështje që është në gjykim, si e tillë ajo nuk mund të përfshihet në vlerësimin e aftësive profesionale.

23. Përkundër sa arsyeton Komisioni, bazuar në argumentet që janë përdorur prej tij (Komisionit), nga burimet e hapura të informacionit (*open sources*) rezulton se vendimi i referuar, marrë nga GJEDNJ, edhe pse lidhet me të njëjtën ngjarje, ka të bëjë me një procedim të pezulluar e të ndarë, të ndryshëm nga ai që është objekt i gjykimit të konkluduar me vendimin nr.***, datë **.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

24. Në referencë të shpjegimeve të paraqitura me shkrim nga ana e subjektit të rivlerësimit, pas dërgimit të aktit “Rezultate të hetimit” nga ana e Komisionit, ky i fundit do të duhej t’i kishte marrë në vlerësim ato dhe të argumentonte një qëndrim, që lidhet me gjetjet përkatëse, duke çmuar dhe mbajtur në konsideratë njëkohësisht edhe jurisprudencën e Kolegjit²³. Në të tilla rrethana, kjo çështje duhet të gjejë trajtim në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar nga ana e Kolegjit.

III. Kërkimi i ankimit

25. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes

²³ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 9/2020, prg. 16.5 - 16.10.

së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

26. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

27. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

28. Bazuar në nenin Ç, D dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3, 5 të ligjit nr. 84/2016;

29. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.

**KOMISIONERI PUBLIK
FLORIAN BALLHYSA**